


ME PUNË I BËJMË ËNDRRAT REALITET



RESPEKTIMI I TË DREJTAVE NË DEMOKRACI

ENDRIT (11), VALËZON (11), ENDI (11), KURBIN (11), ORGES (11), VLERË (11), TRINGA (12), ANEA (12),
VIOLA (11)



Çfarë është demokracia dhe cilat janë elementet kryesore të saj?


Demokracia është formë e qeverisjes në të cilën udhëheq populli. Fjala demokraci rrjedh prej fjalëve të vjetra greke ku „demos“ do të thotë popull dhe „kracia“ udhëheqje. Ajo ndahet në dy forma kryesore: në demokracinë e drejtpërdrejtë dhe në demokracinë përfaqësuese. Në demokracinë e drejtpërdrejtë populli merr vendime aty për aty. Ndërsa, në demokracinë përfaqësuese populli i zgjedh përfaqësuesit, të cilët pastaj marrin vendime në emër të popullit.

Demokracia ka këto elemente: të drejtat e njeriut, lirinë, barazinë, respektin, tolerancën, solidaritetin, paqen, etj. Ne e duam lirinë vetëm kur të gjithë e gëzojnë atë. Prandaj, në demokraci liria e gjithë popullit është një ndër elementet më të rëndësishme. Po ashtu, të gjithë qytetarët kanë të drejta të barabarta, pa dallim feje, race, gjinie, feje, etj. Falë kësaj forme të qeverisjes, ne respektojmë edhe mendimet e të tjerëve, pavarësisht sa të ndryshme mund të jenë ato. Toleranca kuptohet bukur vetëm kur e lejojmë njëri-tjetrit të shprehim mendimet tona dhe duke bashkëpunuar në mënyra të ndryshme.

Tani do të tregojmë si shembuj disa situata se si qytetarët jetojnë në një vend demokratik. Zakonisht kur koha fillon të ngrohet, njerëzit dalin të ecin në qytet apo në natyrë, sepse ata janë të lirë dhe gëzojnë të drejtën e lëvizjes. Fëmijët luajnë lojëra të ndryshme, sepse e kanë të drejtën e lojës. Kurse, shokët dhe sho-

qet i dëgjojnë mendimet e njëri-tjetrit, sepse kanë tolerancë ndërmjet vete.

Si përfundim dëshirojmë të themi se në mënyrë që jeta jonë të jetë sa më e mirë dhe sa më paqësore, ne duhet të punojmë sikur bletat punëto.




E drejta e lojës është e pranishme këtu në demokraci



Grupi „Politikanët e Vegjël“

RËNDËSIA E PROCESIT ZGJEDHOR

AMINA (12), DONIK (12), DREN (11), ENESA (11), VESA (11), ANDI (12), DUA (11), EURELA (12),
ENIS (12)



Pse duhet të votojmë? Këtë përgjigje mund ta gjeni në këtë artikull

Ishte periudhë shumë e rëndësishme për vendin tonë. Të gjithë qytetarët ishin të angazhuar dhe të preokupuar me procesin zgjedhor, i cili do të ndodhte pas dy javësh. Kudo në media flitej vetëm për zgjedhjet dhe rëndësinë e tyre. Procesi zgjedhor konsiderohet pro-

datëve për deputetë. Megjithatë, shoqja ime e ngushtë nuk ishte kaq e entuziazmuar sa unë. Ajo vazhdonte të thoshte se nuk i dukej edhe aq e rëndësishme pjesëmarrja e saj në zgjedhje.

Një ditë i thashë asaj se duhet të bisedonim. Më pas filluam të flasim për zgjedhjet. Unë i tregova se vota është e drejtë e të gjithë qytetarëve të shteteve demokratike. I thashë se një votë e saja mund të jetë pikërisht arsyeja pse shteti ynë merr kahje tjetër. Ajo u bind dhe më falenderoi që ia tregova rëndësinë e votës. Edhe ju lexues të dashur të këtij artikulli, mos mendoni se vota juaj nuk ka rëndësi. Edukatorja jonë këtu në Punëtori na tregoi ndryshimin mes numrit 99 dhe atij 100. E dini ju dallimin? Numrit 99 vetëm një numër i shtohet dhe ai bëhet 100. Pa këtë numër, numri 99 mbetet prapë 99. Pra, vetëm një votë e jona, mund të ndikoj në ndryshimin pozitiv të vendit tonë.




Këto ndryshe njihen si: zgjedhjet qendrore dhe lokale

cesi më demokratik. Në këtë proces, qytetarët me anë të votave të tyre, vendosin për të ardhmen e të gjithë vendit, duke zgjedhur kështu përfaqësuesit e shtetit. Në anën tjetër, kjo ishte diçka e re për mua. Unë gjithmonë e kam ditur rëndësinë e zgjedhjeve. Mirëpo, asnjëherë nuk e kisha marrë më seriozisht se tani. Vitin e kaluar kisha mbushur 18 vjet dhe kjo do të ishte pjesëmarrja ime e parë në zgjedhje. Javët e fundit kisha përcjellur me vëmendje të gjitha fushatat e kandi-



Të gëzuar që sot ishim gazetarë



Procesi zgjedhor duhet të ndodh çdo katër vjet. Mirëpo, ka raste kur kemi zgjedhje të parakohshme apo të jashtëzakonshme



Të votosh nënkupton të jesh pjesë e vendimmarrjes dhe të japësh kontribut për vendin dhe të ardhmen e vendit tënd



Vota është e drejta jonë, e cila iu takon të gjithë qytetarëve mbi moshën 18 vjeçare pa dallim feje, race, gjinie, etj



Ne nuk bëjmë zgjedhje vetëm atëherë kur marrim pjesë në procesin zgjedhor. Ne bëjmë zgjedhje çdo ditë, si shoqja jonë Ana në vizatim



E ardhmja e planetit tonë është me të vërtetë në duart tona



Të bëhemi aktiv duke u angazhuar në organizata të tilla

QYTETARI AKTIV DHE QYTETARI PASIV

ELION (12), ULPIANA (11), JONIDA (12), ALMIRA (11), MIA (11), TRINGË (11), DION (12), NARONA (12)



Në këtë artikull ne do të mësojmë dallimin mes qytetarit aktiv dhe qytetarit pasiv. E ne kemi zgjedhur të jemi aktiv. Mësoni më shumë

Qytetarët e shteteve demokratike janë qytetarët më të lumtur në botë. Kjo pasi që të gjithë pa asnjë dallim dhe në mënyrë të barabartë gëzojnë të drejtat e tyre. Ndër vite qytetarët e këtyre shteteve kanë kontribuar në mënyrë pozitive apo negative për shtetin e tyre. Kur themi në mënyrë pozitive, ata kanë dhënë kontributin



Të bashkuar për një të ardhme edhe më të ndritur

e tyre për zhvillimin e shtetit, e kur themi në mënyrë negative ata kanë dëmtuar shtetin e tyre. Pikërisht, kjo e bën dallimin mes qytetarëve aktiv dhe pasiv. Qytetarët aktiv janë ata të cilët: paguajnë rregullisht taksat, mbrojnë mjedisin ku jetojnë, i respektojnë ligjet, votojnë, protestojnë në mënyrë paqësore në raste pakënaqësie, ndihmojnë të varfërit, të moshuarit, njerëzit me nevoja të veçanta, etj. Ndërsa, qytetarët

pasiv janë ata të cilët: nuk kontribuojnë për shtetin e tyre, nuk preokupohen me të ardhmen e shtetit, nuk votojnë, nuk e shprehin vullnetin e tyre të lirë, hedhin mbeturinat në tokë, nuk i ndihmojnë të tjerët dhe nuk ndihen pjesë e komunitetit të tyre.


Tërë këto veprime të cekura nuk e ndihmojnë zhvillimin e shtetit. Andaj, ne kemi zgjedhur që të jemi qytetarë aktiv dhe kontribut-dhënës për shtetin tonë.

Edhe mbeturinën më të vogël që mund ta kemi në duart tona e mbajmë në xhep dhe nuk e hedhim në tokë, sepse çdo pëllëmbë e shtetit tonë është e vlefshme. Çdokush që e di rëndësinë e shtetit të tij demokratik, duhet të jetë qytetar aktiv, e të mos pres që detyrat dhe obligimet e tij t'i kryej dikush tjetër. Kjo nënkupton që asnjëherë nuk duhet të ketë shpërndarje të pabarabartë të përgjegjësisë. Secili duhet të jetë përgjegjës dhe i vetëdijshëm për veprimet e veta.

Kjo ishte e tëra që kemi përgatitur për ju. Faleminderit!



Fëmijët gazetarë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Ismail Qemali“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë